



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 9466 Prot

Shkodër, më 10.06.2022

URDHËR

Nr. 489, datë 10.06.2022

“Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Gradave për punonjësit e nivelit bazë të MZSH”

Mbështetur në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, në ligjin nr.44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në kreun IV, të ligjit nr.152/2015 “Për shërbimin e Mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, Vendimin nr.895, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e ecurisë dhe të fitimit të gradave, njësimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën dhe specifikimet teknike të gradave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, të pikës 4 të udhëzimit nr.60, datë 09.05.2022 të Ministrit të Brendshëm “Për përbërjen dhe funksionimin e komisioneve të vlerësimit të gradave” dhe në vijim të shkresës nr.249 prot, datë 12.05.2022 të Drejtorisë së Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, institucion në varësi të Bashkisë Shkodër me lëndë: “Kërkesë për “Ngritjen e komisionit të vlerësimit të gradave për punonjësit e nivelit bazë të MZSH-së Shkodër”, administruar me nr.7607 prot, datë 12.05.2022,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e “Komisionit të Vlerësimit të Gradave” për nivelin bazë të strukturave të MZSH-së në Bashkinë Shkodër.
2. Komisioni i Vlerësimit të Gradave në nivel vendor, Bashkia Shkodër përbëhet si më poshtë:
 - Drejtori i Drejtorisë së Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, institucion në varësi të Bashkisë Shkodër – Kryetar
 - Specialisti i Sektorit të Burimeve Njerëzore pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Bashkinë Shkodër – Anëtar
 - Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të MZSH-së – Anëtar.
3. Komisioni i Vlerësimit të Gradave funksionon si organ kolegjal vlerësues dhe propozon në zbatim të dispozitave të ligjit nr.152/2015 “Për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe shpëtimin” për fitimin e gradës. Komisioni dërgon aktet e vlerësimit për punonjësit e MZSH-së tek autoritetet e përcaktuara në nenin 24 të ligjit.

4. Komisioni i Vlerësimit të Gradave trajton çdo kërkesë të punonjësve të shërbimit të MZSH-së, për vlerësimin e gradave, brenda 30 ditëve nga depozitimi i kërkesës.
5. Komisioni i Vlerësimit të Gradave në përfundim të shqyrtimit të kërkesës harton aktin e vlerësimit në përputhje me kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe shpëtimin” dhe vendimit nr.895, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave, njësimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën dhe specifikimet teknike të gradave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.
6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, institucion në varësi të Bashkisë Shkodër dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.
7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Bardh SPAHIA

